



Datë: 21.07.2025
Numër Protokolli: 5806/2025

A.nr.1190/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës më numër A.nr.1190/2025, të datës 23.06.2025, të parashtruar nga ankuesi H.H në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetjeje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, më datë 21.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1190/2025, e datës 23.03.2025, e parashtruar nga ankuesi H.H.
- II. Mbetet në fuqi** Njoftimi me numër protokolli 14-111/01-0089139/25, i datës 20.06.2025, i Sektorit të Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, lidhur më përfundimin e procedurës së pranimit me nr.ref: RN00017705, pozita Udhëheqës i Sektorit për Transport dhe Trafik.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil H.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 23.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të testimit me shkrim, në procedurën e pranimit më Nr.Ref: RN00017705, pozita e punës *Udhëheqës i Sektorit për Transport dhe Trafik*, i shpallur nga Komuna e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 04.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 10.07.2025, ka përcjell shkresat ndërlidhur me çështjen në procedurë, duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4262/2025 të datës 23.06.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin me numër protokolli 14-111/01-0089139/25, të datës 20.06.2025, të Sektorit të Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës; Njoftimin për verifikim paraprak i datës 05.06.2025; Konkursin me Nr. Reference RN00017705, për pozitën e punës ”Udhëheqës i Sektorit për Transport dhe Trafik”, i shpallur nga Komuna e Prishtinës; Njoftimin nga SIMBNJ për aneksin i datës 18.06.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën e datës 04.07.2025 për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë e datës 10.07.2025; Listën e aplikantëve; Vendimin e datës 21.05.2025 për përbërjen e komisionit të pranimit; Listën e rezultatit të testit me shkrim; Çelësin e esesë; Formularin e vlerësimit të esesë për ankuesin; Dosjen e ankuesit me 33 faqe; Testin me shkrim.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se:

- Komuna e Prishtinës më datë 25.04.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Ref: RN00017705, për pozitën e punës ”Udhëheqës i Sektorit për Transport dhe Trafik”, me afat aplikimi 26.04.2025 deri me 25.05.2025.
- Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është përfshirë në listën e kandidatëve që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, dhe së i është nënshtruar fazës së vlerësimit përmes testit me shkrim. Rrjedhimisht, testimit më shkrim i janë nënshtruar ankuesi dhe kandidati E.Kadriu, ashtu që ankuesi ka marrë vetëm 29.4 pikë, ndërsa kandidati E. Kadriu 24.4 pikë, pikë këto të pamjaftueshme për fazën tjetër të vlerësimit gjegjëshit intervistën më gojë.
- Sektori i Burimeve Njerëzore më datë 20.06.2025 ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 14-111/01-0089139/25, për përfundim të procedurës pasi që asnjë nga kandidatët nuk ka arritur pikët e nevojshme në testim më shkrim.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon së ka përgatitjen profesionale për këtë pozitë, testi me shkrim për këtë pozitë ka qenë jo profesional ngase ishin përfshirë pyetje që nuk ishin në përputhje me fushën profesionale të pozitës dhe së Komisioni i Pranimit ka qenë jo profesional sepse nuk kanë drejtimin përkatës. Kërkon të aprovohet ankesa të kthehet ky proces në procedurë të rivlerësimit.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e konkursit me numër reference RN00017705 dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Drejtimi Inxhinieri i Ndërtimtarisë, Inxhinieri i Arkitekturës, Inxhinieri i Komunikacionit dhe Telekomunikacionit. Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Ndërsa, në kuptim të pretendimeve ankimore Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

-Nenit 9 paragrafi 1 : *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj”.*

-Nenit 44: *1. Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë..... 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimi për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë....”*

Bazuar në kuadrin ligjor si me sipër dhe referuar pretendimit lidhur vlerësimin e testit me shkrim, Kolegji ka shqyrtuar testin e aplikuar në këtë procedurë rekrutimi, nga dhe ka vërtetuar së pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatët, testi ka përmbajt 25 pyetje më përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseja, gjegjësisht pyetjet e testit me shkrim janë paraparë të tipit të kombinuar me pyetje të përgjithshme dhe me pyetje që ndërlidhen me vendin e punës, po ashtu edhe eseja ka qenë e përpiluar me temë trajtimi lidhur më pozitën përkatëse. Rrjedhimisht, Kolegji nuk verën të meta në vlerësimin e drejtë të ankuesit lidhur me testin me shkrim, sepse, ankuesi ka dhënë përgjigje të sakta në 13 pyetje, duke u vlerësuar më 26 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar me nga dy pikë), ndërsa, në ese është vlerësuar me 3.4 pikë nga 20 pikë maksimale, duke arritur gjithsej 29.4 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, sikurse parashihet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.* Gjegjësisht, ankuesi edhe në rast të vlerësimit të eses më pikët maksimale (20 pikë) nuk do akumulonte pikë të nevojshëm për kalim të kësaj faze, sepse, i njëjti ka dhënë vetëm 13 përgjigje të sakta, që nënkuptoni së ankuesi potencialisht mund të arrinte vetëm 46 pikë, të pamjaftueshëm për kalim në fazën e intervistës më gojë. Andaj, mbi këto rrethana pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me vlerësimin e testit me shkrim janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Komisioni i Pranimi ka qenë jo profesional sepse nuk kanë drejtimin përkatëse, Kolegji i Këshillit, ka analizuar përbërjen e Komisionit të Pranimi dhe se nga analizimi i provave të lëndës, gjegjësisht bazuar në Vendimin për themelimin e Komisionit të Pranimi me numër 14-02-/04-705358/25 të datës 21.05.2025, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ka konstatuar së përbërja e komisionit të pranimi, ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara nga neni 45 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni i pranimi. 2. Komisioni i pranimi për pozita të kategorisë së ulët dhe të*

mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunëse/ës civil nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë, Rrjedhimisht, Komisioni i pranimit ka qenë në përbërje nga: H .Q, në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit për Shërbime Publike, D.G , në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit, E.P, në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit për Bashkësi Lokale, dhe E.T, në pozitën e Zyrtarit të Lartë të Burimeve Njerëzore.

Konstatuar si më lartë dhe rrjedhimisht duke qenë se nuk janë evidentuar parregullsi ligjor lidhur me fazën e vlerësimit profesional si objekt i kësaj ankesë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, më përfundimin e procedurës së kontestuar sipas Njoftimit me numër protokolli 14-111/01-0089139/25, të datës 20.06.2025, ka vepruar në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse, vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë, andaj, duke qenë se asnjëri nga kandidatët nuk ka arrit pikët e nevojshëm në testin me shkrim atëherë, ex lege është plotësuar kushti që procedura të përfundoj pa kandidatë fitues, kështu që, bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.1190/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

-Ankuesit H.H;

-Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe;

-Arkivit të KPMSHCK-së.